

Më
 Data 23-04-2018

P.nr. 3273/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
 Divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren, Hysnije Gashi si dhe me
 zyrtare ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër te akuzuarave, [REDACTED] me
 vendbanim ne fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, dhe [REDACTED] me vendbanim në
 rr." [REDACTED] Komuna Prishtine, për shkak te veprës penale rrezikimi i trafikut
 publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë
 Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2381-7/17 të datës 21 dhjetor 2017, duke vendosur lidhur
 me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë,
 gjykata me dt.13.02.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr.2381-7/17 të datës 21 dhjetor 2017,
 dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

[REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, i lindur me
 [REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ëmë [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] i gjendjes se mesme ekonomike,
 shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

[REDACTED] me vendbanim ne rr." [REDACTED]", Komuna Prishtinë, i lindur me
 [REDACTED], ne Prishtine nga i ati [REDACTED] i gjendjes se mesme ekonomike, punon si agjente
 doganor, terminali doganor [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse me date 21 tetor 2017 rreth orës 04:00 h, në rrugën " Tahir Sinani " në Ferizaj, i
 pandehuri [REDACTED] duke e drejtuar automjetin e markës " Mercedes Chrysler" me

ngjyre te zeze me tabela te regjistrimit [REDACTED] ka rrezikuar trafikun publik duke vu ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre , me ç' rast ka vepruar ne kundërshtim me ligjin te dispozitës ligjore neni 41.1 te Ligjit për rregullat e trafikut Rrugor, ashtu qe ndërmerri një veprim pa u siguruar se mund te rrezikoj pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacion dhe nga pakujdesia, del nga parkingu për tu kyçur ne rrugën kryesore me ç' rast gjate kyçjes goditet ne anën e majte te pjesës se përparme te automjetit nga automjeti i markës "Golf VW" me tabela te regjistrimit [REDACTED] te cilin e drejtonte i pandehuri [REDACTED] i cili ne atë momente kritik nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me me ç' rast ka vepruar ne kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 53.1 Ligjit për Rregullat e trafikut Rrugor, ku si pasoj e këtij aksidenti shkaktohet dem material ne te dy automjetet si dhe lëndime trupore pëson i dëmtuari [REDACTED], e qe bazuar ne ekspertizën mjeko ligjore te datës 04 nëntor 2017, lëndime te tilla bëjnë pjesë ne lëndime te lehta trupore dhe me pasoja te përkohshme për shëndetin .

Me te cilën kryen veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KPRK-së.

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurin [REDACTED] me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurin [REDACTED], me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Gllogoc, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohen të pandehurit që secili veq e veq në emër të shpenzimeve procedurale të paguajn shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2381-7/17 të datës 21 dhjetor 2017, ka akuzuar të pandehurit [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Shtime dhe [REDAKTUAR] me vendbanim në rr." [REDAKTUAR] Komuna Prishtine, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.949-7/16 të dt. 14.12.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: raporti i aksidentit me nr.2017-709 e datës 21.10.2017 ekspertiza e ekspertit të komunikacionit e datës 30.11.2017, ekspertiza mjeko-ligjore të datës 02.12.2017 si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

I dëmtuari [REDACTED] me vendbanim ne fshatin [REDACTED] Komuna Glllogoc, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen ne kontest civil .

Obligohen të pandehurit që secili veq e veq në emër të shpenzimeve procedurale të paguajn shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DIVIZIONI PENAL

P.nr.3273/17 dt.14.02.2018

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtari i vetem gjykues,

Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim,
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimet të aktgjykimit
të njëjtës gjykatë.